



Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment, Forests and Water Administration in Albania for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation

Draft

Vendim i Këshillit të Ministrave

“Për Miratimin e Rregullores Për Instalimet Marrëse Portuale dhe Kërkesat Për Mbetjet e Krijuara nga Anijet dhe Tepricat nga Ngarkesat në Portet e Republikës së Shqipërisë¹”

Draft 3

Versioni 1

19 Mars 2013

** Ky vendim përfaqëson plotësisht Direktivën 2000/59/EC “Mbi instalimet marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anija dhe teprica nga ngarkesat” ndryshuar nga Direktiva 2002/84/EC, Rregullorja (EC) 2007/71/EC dhe Rregullorja (EC) 1137/2008. Numri CELEX 32000L0059, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.332, datë 28.12.2000, faqe 81.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. _____, datë _____

Për Miratimin e Rregullores “Për Instalimet Marrëse Portuale dhe Kërkesat për Mbetjet e Krijuara nga Anijet dhe Tepricat nga Ngarkesat në Portet e Republikës së Shqipërisë *

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 40 të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për instalimet marrëse portuale dhe kërkesat për mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat në Portet e Republikës së Shqipërisë” sipas Rregullores dhe Anekseve bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ministri përgjegjës për mjedisin dhe Ministri përgjegjës për transportin janë përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Drejtoria e Përgjithshme Detare është përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Kapiteneria e Portit/Kontrolli Shtetëror Portual është përgjegjës për inspektimin në përputhje me këtë Vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi 1 vit pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

SALI BERISHA

* Ky vendim përaftron plotësisht Direktivën 2000/59/EC “Mbi instalimet marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anija dhe teprica nga ngarkesat” ndryshuar nga Direktiva 2002/84/EC, Rregullorja (EC) 2007/71/EC dhe Rregullorja (EC) 1137/2008. Numri CELEX 32000L0059, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.332, datë 28.12.2000, faqe 81.

RREGULLORE

“Për instalimet marrëse portuale dhe kërkesat për mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat në portet e Republikës së Shqipërisë”

I. QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është mbrojtja e mjedisit detar përmes reduktimit të shkarkimit në det të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe të tepcave nga ngarkesat e tyre, veçanërisht të shkarkimeve të paligjshme nga anijet që përdorin portet e Republikës së Shqipërisë, duke përmirësuar disponibilitetin dhe përdorimin e instalimeve marrëse përkatëse të porteve.

II. OBJEKTI

2. Kjo rregullore do të zbatohet për:
 - a) Të gjitha anijet, përfshirë mjetet e peshkimit dhe mjetet lundruese për argëtim, pavarësisht nga flamuri, shenja e thirrjes apo veprimtaria e tyre brenda një porti Shqiptar, me përjashtim të anijeve të luftës, mjeteve ndihmëse detare, anijeve të tjera në pronësi apo që administrohen dhe përdoren aktualisht nga shteti vetëm për shërbime qeveritare jo tregtare; dhe
 - b) Të gjitha portet e Republikës së Shqipërisë që vizitohen normalisht nga anijet e përcaktuara në shkronjën (a) më sipër.
3. Drejtoria e Përgjithshme Detare duhet të marrë masa për të siguruar që anijet e përjashtuara nga objekti i kësaj rregullore sipas paragrafit 2(a), i dorëzojnë mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre në mënyrë të vazhdueshme, për aq sa është e lejueshme dhe e zbatueshme sipas kësaj rregullore.

III. PËRKUFIZIME

4. Termat e përkufizuar në nenin 3 të Ligjit nr.10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:
 - a) “**Anije**” është një mjet lundrues i çdo lloji, cilido qoftë funksionimi i saj në mjedisin detar, dhe përfshin motoskafët me fletë të nënujshme, mjetet me jastëk ajror, nëndetëset dhe mjetet lundruese;
 - b) “**Autoritet portual**” është enti që është krijuar dhe ushtron kompetencat e tij në përputhje me Ligjin nr.9130, datë 8.9.2003 “Për autoritetin portual”;

- c) **“Certifikata e dorëzimit të mbetjeve”** është formulari (që jepet në Aneksin IV të kësaj rregullore) i plotësuar që vërteton se anija ja ka dorëzuar mbetjet operatorit të instalimeve marrëse sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore;
- d) **“Drejtoria e Përgjithshme Detare”** (DPD) është organi administrativ sipas përcaktimit në Ligjin No.10109, datë 2.4.2009 “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”;
- e) **“Instalim marrës portual”** është çdo instalim i palëvizshëm, lundruar ose i lëvizshëm i aftë të marrë mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, i cili menaxhohet nga operatori;
- e) **“Kapiteneria e portit”** është organi administrativ sipas përcaktimit në Ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”;
- dh) **“Kapiteni i anijes”** ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.9130 datë 8.9.2003 “Për autoritetin portual”;
- f) **“Kontrolli Shtetëror Portual”** është strukturë e veçantë, në Kapitenerinë e Portit, i cili ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”;
- g) **“Marpol 73/78”** është Konventa Ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga anijet, 1973, të ndryshuar nga Protokollin i 1978 në lidhje me të, e miratuar me ligjin nr. 9594, datë 27.07.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare për Parandalimin e Ndotjeve nga anijet, 1973, të ndryshuar me protokollin e vitit 1973”;
- ë) **“Mjet lundruar për argëtim”** është çdo anije e çdo lloji, pavarësisht mënyrës së forcës shtytëse, që përdoret për qëllime sportive ose në kohën e lirë;
- h) **“Mbetjet e krijuara nga anijet”** janë të gjitha mbetjet e krijuara nga anijet, sipas përcaktimit në nenin 40 të Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, përfshirë ujërat e ndotur dhe tepricat e ndryshme nga ngarkesat, që janë krijuar gjatë shërbimit të anijeve dhe janë objekt i Aneksit I, IV dhe V të MARPOL 73/78, si dhe ngarkesat e lidhura me mbetjet, sipas përcaktimit në udhëzimin për zbatimin e Aneksit V të MARPOL 73/78;
- i) **“Mjet peshkimi”** është çdo anije e pajisur ose që përdoret për kapjen e peshkut ose të gjallesave të tjera të detit për qëllime tregtare;
- gj) **“IMO”** nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare;

- j) **“Operator”** është çdo person fizik ose juridik, mbajtës i liçensës/autorizimit/konçensionit përkatës që operon me instalimet marrëse portuale;
- k) **“Port”** është një vend ose zonë gjeografike e përgatitur përmes punimeve dhe pajisjeve përmirësuese që lejojnë, kryesisht, pritjen e anijeve, përfshirë mjetet e peshkimit dhe mjetet lundruese për argëtim;
- l) **“Tepricat nga ngarkesat”** janë tepricat nga ngarkesat detare, sipas përcaktimit në nenin 40 të Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, përfshirë mbetjet e çdo materiali të ngarkesës në bord, nga mbajtëset e ngarkesave ose çisternat, të cilat teprojnë pas përfundimit të procedurave të shkarkimit dhe pastrimit, përfshirë tepricat nga ngarkim/shkarkimi dhe firot;
- m) **“Tarifa e mbetjeve”** është pagesa që kryen çdo anije që hyn në një port Shqiptare, për mbulimin e kostove të instalimeve marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anijet, përfshirë trajtimin dhe asgjësimin e tyre.

IV. INSTALIMET MARRËSE PORTUALE

- 5. Drejtoria e Përgjithshme Detare duhet të sigurojë instalime marrëse portuale të mjaftueshme që të plotësojnë nevojat e anijeve që përdorin portin pa ju shkaktuar vonesa të pajustificuara.
- 6. Instalimet marrëse duhet të jenë të afta të marrin sasinë dhe llojet e mbetjeve të krijuara nga anijet që përdorin atë port normalisht dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, duke marrë parasysh nevojat funksionale të përdoruesve të portit, madhësinë dhe pozicionin gjeografik të portit, llojin e anijeve që japin shenjën e thirrjes në atë port dhe përjashtimet e parashikuara në paragrafin 24.
- 7. Ministri përgjegjës për transportin në përputhje me kërkesat e IMO përcakton me Urdhër procedurat e raportimit në Kapitenerinë e Portit të rasteve kur pretendohet për efikasitet të pamjaftueshëm të instalimeve marrëse portuale.

V. PLANI I MARRJES DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE

- 8. Drejtoria e Përgjithshme Detare, në konsultim me palët e interesuara, veçanërisht me përdoruesit e porteve, operatorët ose përfaqësuesit e tyre, harton dhe zbaton për çdo port një plan të përshtatshëm për marrjen dhe trajtimin e mbetjeve që merr parasysh kërkesat e seksionit IV, VI, VII, VIII, IX dhe X të kësaj rregulloreje. Kërkesat specifike për hartimin e këtyre planeve përcaktohen në Aneksin I të kësaj Rregulloreje.

9. Plani i referuar në paragrafin 8, kur kërkohet për arsye efektiviteti, mund të hartohet në nivel rajonal ose kombëtar me përfshirjen e çdo porti, duke siguruar që nevojat për instalimet marrëse dhe disponibilitetin e tyre të specifikohet individualisht për çdo port.
10. Ministria përgjegjëse për mjedisin vlerëson, miraton dhe monitoron zbatimin e planit të referuar në paragrafin 8. Plani i marrjes dhe trajtimit të mbetjeve rishikohet dhe miratohet të paktën çdo tre vjet si dhe pas ndryshimeve të rëndësishme në funksionimin e portit.

VI. NJOFTIMI

11. Kapiteni i anijes, përvec mjeteve të peshkimit ose mjeteve lundruese për argëtim të autorizuar për të mbajtur jo më shumë se 12 pasagjerë, që detyrohet të lidhet me një port në Shqipëri, duhet të plotësojë me vërtetësi dhe saktësi formularin e paraqitur në Aneksin II dhe t'ia njoftojë Kapitenerisë së Portit:
 - a) të paktën 24 orë para mbërritjes, në qoftë se porti i thirrjes është i njohur; ose
 - b) sapo të njihet porti i thirrjes, në qoftë se informacioni i kërkuar sigurohet në më pak se 24 orë përpara mbërritjes; ose
 - c) pak kohë pas largimit nga porti i mëparshëm, në qoftë se kohëzgjatja e udhëtimit është më pak se 24 orë.
12. Kapiteneria e Portit i dërgon një kopje të njoftimit Portit/Autoritetit Portual dhe operatorit të instalimeve marrëse portuale. Operatori është i detyruar të mbajë një regjistër për njoftimet dhe certifikatat e dorëzimit të mbetjeve dhe t'ia përcjellë ato çdo muaj Drejtorisë së Përgjithshme Detare.
13. Kapiteni i anijes e mban informacionin e referuar në paragrafin 11, në bordin e anijes të paktën deri në portin tjetër të thirrjes dhe me kërkesën e tyre ja vë në dispozicion Kapitenerisë së Portit ose organeve të tjera të caktuara për këtë qëllim nga Ministria përgjegjëse për transportin.

VII. DORËZIMI I MBETJEVE TË KRIJUARA NGA ANIJET

14. Kapiteni i anijes që jep shenjën e thirrjes në një port Shqiptar, përpara largimit nga porti, i dorëzon të gjitha mbetjet e krijuara nga anija në një instalim marrës portual.
15. Pavarësisht nga sa është parashikuar në paragrafin 14, anija mund të vazhdojë për në portin tjetër të thirrjes pa dorëzuar mbetjet e krijuara nga anija, në qoftë se sipas informacionit të dhënë në përputhje me Seksionin VI dhe Aneksin II, ka kapacitet magazinimi të mjaftueshëm për të gjitha mbetjet e krijuara nga anija që janë mbledhur dhe do të mblidhen gjatë udhëtimit të planifikuar të anijes deri në portin e dorëzimit.
16. Kapiteneria e Portit, kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se porti i planifikuar për dorëzimin e mbetjeve nuk disponon instalimet e duhura ose në qoftë se ky port është i

panjohur dhe si pasojë ka rrezik që mbetjet të shkarkohen në det, merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndotjen detare dhe/ose i kërkon anijes të dorëzojë mbetjet e saj përpara largimit nga porti.

17. Paragrafi 15 zbatohet pavarësisht kërkesave më shtrënguese për anijet që lidhen me dorëzimin e mbetjeve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

VIII. TARIFA PËR MBETJET E KRIJUARA NGA ANIJET

18. Ministria përgjegjëse për transportin pas konsultimeve me Ministrinë përgjegjëse për mjedisin sigurojnë që kostot e instalimeve marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anijet, përfshirë trajtimin dhe largimin e tyre, të mbulohen përmes mbledhjes së tarifës për mbetjet nga anijet.
19. Ministri përgjegjës për transportin dhe Ministri përgjegjës për financat, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, miratojnë tarifën për shërbimet e mbetjeve referuar në paragrafin 18, në muajin Dhjetor të çdo viti parardhës. Kriteret minimale për përcaktimin e tarifës së mbetjeve për shërbimet dhe përdorimin e instalimeve marrëse portuale përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare në përputhje me Aneksin III të kësaj Rregullore.
20. Tarifa e mbetjeve i faturohet të gjitha anijeve që japin shenjën e thirrjes në portet Shqiptare nga operatori i instalimeve marrëse në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 19. Tarifa e mbetjeve i jepet anijeve për të dorëzuar një sasi të arsyeshme mbetjesh (Aneksi I, IV dhe V e Marpol 73/78) pa pagesë, sipas përcaktimit dhe publikimit në planin për largimin dhe trajtimin e mbetjeve, referuar në paragrafin 8 të kësaj Rregullore.
21. Për të siguruar që tarifa e mbetjeve është e drejtë, transparente, jo diskriminuese dhe pasqyron kostot e instalimeve dhe të shërbimeve të vëna në dispozicion dhe, sipas rastit, të përdorura, vlera e tarifës dhe baza sipas së cilës ajo llogaritet duhet të bëhet e qartë për përdoruesit e portit dhe të përshkruhet në planin e marrjes dhe trajtimit të mbetjeve në përputhje me Aneksin I të kësaj Rregullore.
22. Sistemet e mbulimit të kostos për përdorimin e instalimeve marrëse portuale duhet të jenë të tilla që të mos stimulojnë anijet që të shkarkojnë mbetjet e tyre në det. Për këtë qëllim, për anijet e autorizuar për të mbajtur jo më shumë se 12 pasagjerë, përveç mjeteve të peshkimit dhe mjeteve lundruese për argëtim, zbatohen parimet e mëposhtme:
 - a) anija që i jep shenjën e thirrjes një porti Shqiptar, i dorëzon mbetjet e krijuara prej saj tek operatori i mbetjeve dhe/ose tek instalimet marrëse portuale, paguan tarifën e mbetjeve, të përcaktuar në paragrafin 18, si dhe një tarifë shtesë në rast dorëzimi të një sasive mbetjesh më tepër se sasia e arsyeshme, referuar në paragrafin 20;

- b) anija, kur nuk i dorëzon mbetjet e krijuara prej saj, i paguan operatorit të mbetjeve tarifën e mbetjeve, të përcaktuar sipas paragrafit 18, pa tarifën shtesë. Tarifa e mbetjeve do të kontribuojë konsiderueshëm në kostot e referuara në paragrafin 22, pavarësisht nga përdorimi aktual i instalimeve. Për këtë qëllim, Kapiteneria e Portit vendos që kjo tarifë të mund të përfshihet në tarifën e portit ose si një tarifë e veçantë për mbetjet;
- c) tarifa e mbetjeve mund të ndryshojë ndër të tjera, sipas kategorisë, llojit dhe madhësisë së anijes, në përputhje me kriteret e përcaktuara në tabelën në Aneksin III dhe udhëzimet përkatëse të Ministrit përgjegjës për transportin.
- d) tarifa e mbetjeve mund të reduktohet, në qoftë se menaxhimi mjedisor i anijes, projekti, pajisja dhe funksionimi janë të tilla që kapiteni i anijes mund të provojë se ajo krijon sasi të vogla mbetjesh.

IX. PËRJASHTIME

- 23. Kapiteneria e Portit mund të përjashtojë nga pagesa e tarifës së mbetjeve vetëm anijet që kanë kapacitet magazinimi të mjaftueshëm për të lundruar drejt portit tjetër të thirrjes.
- 24. Drejtoria e Përgjithshme e Porteve mund të përjashtojë anijet nga detyrimet e parashikuara në Seksionin VI, VII dhe VIII kur ato angazhohen në trafik të planifikuar me thirrje portuale të vazhdueshme dhe të rregullta dhe kur ka prova të mjaftueshme të një marrëveshje që siguron dorëzimin e mbetjeve të krijuara nga anija dhe pagesën e tarifës në një port përgjatë rrugës së anijes.
- 25. Kapiteneria e Portit informon rregullisht, të paktën një herë në vit, ministrinë përgjegjëse për transportin dhe ministrinë përgjegjëse për mjedisin për përjashtimet e bëra sipas paragrafit 24.

X. DORËZIMI I TEPRICAVE NGA NGARKESAT

- 26. Kapiteni i anijes që jep shenjën e thirrjes në një port Shqiptar duhet të sigurojë që tepricat nga ngarkesat dorëzohen në një instalim marrës portual në përputhje me dispozitat e Marpol 73/78. Përdoruesi i instalimeve marrëse portuale paguan tarifën për dorëzimin e tepricave nga ngarkesat.

XI. ZBATIMI

- 27. Kontrolli Shtetëror Portual/Kapiteneria e Portit duhet të sigurojë që çdo anije mund të jetë objekt inspektimi për verifikimin e përputhshmërisë së saj me dispozitat e parashikuara në Seksionin VII dhe X dhe që do të kryhet një numër i mjaftueshëm inspektimesh.

28. Kontrolli Shtetëror Portual/Kapiteneria e Portit kur përzgjedh për inspektim anije të autorizuar për të mbajtur jo më shumë se 12 pasagjerë, përveç mjeteve të peshkimit dhe mjeteve lundruese për argëtim:

a) i kushton vëmendje veçanërisht:

- i. anijeve që nuk plotësojnë kërkesat për njoftim të parashikuara në Seksionin VI;
- ii. anijeve që nga shqyrtimi i njoftimit sipas Seksionit VI rezultojnë se nuk plotësojnë kërkesat e kësaj rregullore;

b) vepron në kuadër të ligjit nr.9852, datë 26.12.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit “Për Kontrollin Shtetëror Portual”;

c) në qoftë se nuk bindet nga rezultatet e këtij inspektimi duhet të sigurojë që anija të mos largohet nga porti pa dorëzuar, sipas Seksionit VII dhe X, mbetjet e krijuara dhe tepricat nga ngarkesat e saj në instalimin marrës portual;

ç) informon autoritetin kompetent të portit tjetër të thirrjes kur ka të dhëna të sigurta se anija ka dalë në det pa plotësuar dispozitat e Seksionit VII dhe X. Ky i fundit, përveç sa parashikohet në sanksionet e Seksionit XIII, nuk duhet ta lejojë anijen të largohet nga ai port derisa të kryejë një vlerësim më të detajuar të zbatimit të kësaj rregullore, veçanërisht të saktësisë së çdo informacioni të dhënë sipas Seksionit VI.

29. Ministria përgjegjëse për transportin përcakton procedurat e kontrollit që sigurojnë plotësimin e kërkesave të kësaj rregullore nga mjetet e peshkimit dhe mjeteve lundruese për argëtim të autorizuar të mbajnë jo më shumë se 12 pasagjerë.

XII. MASA SHOQËRUESE

30. Ministria përgjegjëse për transportin duhet të:

- a)** marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që kapitenët e anijeve, operatorët e instalimeve marrëse portuale dhe personat e tjerë të interesuar të informohen në mënyrën e duhur dhe të plotësojnë detyrimet që ju burojnë nga kjo rregullore;
- b)** bashkëpunojë me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO dhe çdo ent tjetër tregtar për të siguruar zbatimin efektiv të kësaj rregullore;
- c)** sigurojë që informacioni i njoftuar nga kapitenët e anijeve në përputhje me Seksionin VI të shqyrtohet në mënyrën e duhur;
- ç)** sigurojë që formalitet në lidhje me përdorimin e instalimeve marrëse portuale të jenë të thjeshta dhe të shpejta dhe nxisin kapitenët e anijeve të përdorin instalimet marrëse portuale dhe të shmangin vonesat e pajustificuara të anijeve;
- d)** sigurojë që trajtimi, nxjerrja ose largimi i mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre të kryhen në përputhje me Ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;

dh) informojë të gjitha palët e përfshirë në dorëzimin ose marrjen e mbetjeve të krijuara nga anijet ose tepricat nga ngarkesat e tyre, se mund të kërkojë kompesim për dëmin e shkaktuar nga vonesa të pajustificuara, në përputhje me Kodin Civil dhe Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë.

- 31.** Anija që ka dorëzuar mbetjet e krijuara prej saj dhe tepricat nga ngarkesat mund të largohet nga porti. Autoritetet doganore procedojnë në përputhje me Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.
- 32.** Ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunon me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO-n, për ngritjen e një sistemi të përshtatshëm informacioni dhe monitorimi që:
- a) lehtëson identifikimin e anijeve që nuk kanë dorëzuar mbetjet e krijuara dhe tepricat nga ngarkesat e tyre sipas kësaj rregullore;
 - b) lejon të vlerësohet nëse është arritur qëllimi i përcaktuar në Seksionin 1.
- 33.** Ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunon me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO, për përcaktimin e kriterëve të përbashkëta për identifikimin e anijeve sipas kërkesave të paragrafit 22.

XIII. SANKSIONET

- 34.** Shkeljet e dispozitave të kësaj rregullore, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas nenit 62, të Ligjit nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe sanksione të tjera të parashikuara në Ligjin Nr.9251, datë 8.7.2004 “Për Kodin Detar në Republikën e Shqipërisë”.

XIV. PROÇEDURAT AMENDUESE

- 35.** Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Ministria përgjegjëse për transportin në konsultim të detyrueshëm me Drejtorinë e Përgjithshme Detare për të siguruar përputhshmëri me parashikimet në fuqi të IMO-s, në qoftë se është i nevojshëm përmirësimi i regjimit të përcaktuar nga kjo rregullore, por pa zgjeruar objektin e kësaj rregullore, mund të ndryshojnë përkufizimet në Seksionin III.4, referencat në instrumentat IMO dhe anekset e kësaj rregullore.

XV. RAPORTIMI

- 36.** Drejtoria e Përgjithshme Detare paraqet çdo tre vjet në Ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në Ministrinë përgjegjëse për transportin raportin mbi zbatimin e kësaj rregullore.

ANEKSI I
KËRKESAT PËR PLANIN E MARRJES DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE NË PORT
(Referuar në Seksionin V)

Plani i marrjes dhe trajtimit të mbetjeve në port duhet të mbulojë të gjitha llojet e mbetjeve të krijuara dhe tepricat nga ngarkesat në det që vijnë nga anijet që vizitojnë portin normalisht. Ai duhet të hartohet në përputhje me madhësinë e portit dhe llojet e anijeve që japin shenjën e thirrjes në atë port.

Plani duhet të përfshijë elementët e mëposhtëm:

- vlerësimin e nevojës për instalime marrëse portuale nisur nga nevojat e anijeve që vizitojnë portin normalisht;
- përshkrimin e llojit dhe kapacitetit të instalimeve marrëse portuale;
- përshkrimin e hollësishëm të procedurave për marrjen dhe mbledhjen e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat;
- përshkrimin e sistemit të pagesës;
 - Detaje të tarifës së propozuar;
 - Metodatat e llogaritjes;
- procedurat për raportimin mbi mangësitë e pretenduara të instalimeve marrëse portuale;
- procedurat për konsultimet e vazhdueshme me përdoruesit e portit, kontraktuesit e mbetjeve, operatorët e terminalit dhe palët e tjera të interesuara, dhe
- llojet dhe sasinë e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat të marra dhe të trajtuara.
- Përvec sa më lart plani duhet të përfshijë:
 - Një përmbledhje të legjislacionit përkatës dhe të formaliteteve për dorëzimin e mbetjeve dhe tepricave;
 - Identifikimin e personit ose personave përgjegjës për zbatimin e planit;
 - Një përshkrim të pajisjeve dhe proceseve para-trajtuese në port, nqse ka;
 - Një përshkrim të metodave që janë përdorur për raportimin e përdorimit aktual të të instalimeve marrëse portuale;
 - Një përshkrim të metodave që janë përdorur për raportimin e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve dhe tepricat e ngarkesave të dorëzuara nga anijet; dhe
 - Një përshkrim të mënyrës së largimit të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat.

Procedurat për marrjen, mbledhjen, magazinimin, trajtimin dhe largimin e mbetjeve dhe tepricave nga ngarkesat e anijeve duhet të jenë në përputhje me sistemet e menaxhimit të mjedisit.

Informacioni që i vihet në dispozicion të gjithë përdoruesve të portit:

- Një referencë e shkurtër mbi rëndësinë e dorëzimit të mbetjeve të krijuara nga anija dhe tepricat nga ngarkesat në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;
- Vendodhja e instalimeve marrëse portuale të aplikueshme në çdo vend ankorimi me diagramë/hartë;

- Lista e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat që trajton normalisht;
- Lista e pikave të kontaktit, operatorët dhe shërbimet e ofruara;
- Proçedura e dorëzimit;
- Sistemi i pagesës; dhe
- Proçedurat për raportimin e mangësive të pretenduara për instalimet marrëse portuale.

ANEKSI II

INFORMACIONI QË ANIJA DUHET TË NJOFTOJË PËRPARA HYRJES NË PORTET SHQIPTARE

(Porti i Destinacionit referuar në Seksionin VI)

1. Emri, shenja e thirrjes dhe, sipas rastit, numri IMO i identifikimit të anijes:
2. Flamuri i Shtetit:
3. Koha e vlerësuar e mbërritjes (ETA):
4. Koha e vlerësuar e nisjes (ETD):
5. Porti i mëparshëm i thirrjes:
6. Porti tjetër i thirrjes:
7. Porti i fundit dhe data kur janë dorëzuar mbetjet e krijuara nga anija:
8. Në instalimin marrës portual do të dorëzoni (shëno kutinë e duhur):
 Të gjitha disa asnjë nga mbetjet tuaja?
9. Llojin dhe sasinë e mbetjeve dhe tepricave që do të dorëzohen dhe/ose mbahen në bord, dhe përqindjen që ato zënë në raport me kapacitetin maksimal të magazinimit:
Në qoftë se dorëzoni të gjitha mbetjet plotësoni kolonën e dytë.
Në qoftë se dorëzoni disa ose nuk dorëzoni mbetje, plotësoni të gjitha kolonat.

Lloji	Mbetjet që do të dorëzohen (në m ³)	Kapaciteti maksimal i magazinimit (në m ³)	Sasinë e mbetjeve që do të mbahen në bord (në m ³)	Porti ku do të dorëzohen mbetjet e mbajtura	Sasia e vlerësuar e mbetjeve që do të gjenerohet nga moment i njoftimit deri në mbërritjen në portin tjetër të thirrjes (në m ³)
Vajra të përdorur					
Llumra					
Ujë i sentinave					
Të tjera (specifikoni)					
Mbetje të ngurta					
Mbetje nga ushqimet					
Mbetje plastike					
Mbetje të tjera					
Ujëra të ndotura (1)					
Mbetje që shoqërojnë ngarkesat (2) (specifikoni)					
Tepricat nga ngarkesat (2) (përcaktoni)					

(1) Ujërat e ndotura mund të shkarkohen në det në përputhje me Rregulloren 11 të Aneksit IV të Marpol 73/78. Në rast të një shkarkimi të autorizuar në det kutitë përkatëse nuk plotësohen.

(2) Mund të jenë vlerësime.

ANEKSI III
Kriteret minimale për përcaktimin e tarifës për mbetjet
(Tarifa e mbetjeve referuar në Seksionin VIII)

Tarifat për shërbimet dhe përdorimin e instalimeve marrëse të portuale që referohet në Seksionin VIII, paragrafi 19, do të hartohen në bazë të kriterëve minimale të përcaktuara në këtë Aneks sipas pikave A dhe B.

- A. Tarifa e mbetjeve llogaritet duke shumëzuar tarifën për njësi (që përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare) me faktorin e përcaktuar në pikën B, më poshtë.
- B. Tarifa e mbetjeve mund të ndryshohet në lidhje me, ndër të tjera, kategorinë, llojin dhe madhësinë e anijes, në përputhje me faktorët e përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

1.	Mardhënia midis tipit të anijes, tonazhit dhe mbetjeve të pritshme							
2.	Lloji/GT	<5000	5000 - 9999	10000 - 14.999	15.000 – 19.999	20.000-24.999	25.000 – 29.999	>30.000
3.	Transportues për ngarkesat rifuxhio	1	2	2	2	2	2	3
4.	Anije kontejnerësh	1	2	2	3	3	4	6
5.	Anije për mallra të përgjithshme	1	2	2	2	3	3	3
6.	Anije frutash	1	2	2	2	3	3	3
7.	Cisternë gazi	1	2	2	2	2	4	4
8.	Transportues për karburant rifuxhio	1	2	2	2	2	2	5
9.	Anije për mjete lëvizëse	1	2	2	2	3	4	4
10.	Transportues mjetesh lëvizëse	1	2	2	2	2	2	2
11.	Cisternë, jo për gaz	1	2	2	2	3	3	3
12.	Mjete të tjera	1	2	2	3	3	4	5

ANEKS IV
FORMATI I CERTIFIKATËS SË DORËZIMIT TË MBETJEVE
(referuar në Seksionin VIII të kësaj Rregullore)

ÇERTIFIKATA E DORËZIMIT TË MBETJEVE
(CERTIFICATE OF WASTE DELIVERY)

1.	Emri, adresa, numri i regjistrimit të operatorit të mbetjeve dhe/ose instalimeve marrëse portuale; (Name, address, registration number of the waste operator and/or the port reception facilities)				
2.	Emrin, shenjën e thirrjes dhe, kur është e përshtatshme, numrin IMO të identifikimit të anijes; (Name, call sign and, where appropriate, IMO identification number of the ship)				
3.	Flamurin e Shtetit (Flag State)				
4.	Dorëzimi i mbetjeve (shëno kutinë e duhur) të gjitha <input type="checkbox"/> disa <input type="checkbox"/> asnjë <input type="checkbox"/> të mbetjeve në instalimet marrëse portuale?			Waste delivered (tick appropriate box): all <input type="checkbox"/> some <input type="checkbox"/> none <input type="checkbox"/> of your waste into a port reception facilities?	
5.	Llojin dhe sasinë e mbetjeve dhe tepricave të dorëzuara dhe/ose të mbajtura në bord: (Type and amount of waste and residues delivered and/or remaining on board)				
Lloji (Type)	Mbetjet që do të dorëzohen (në m ³) (Total waste delivered m3)	Kapaciteti maksimal i magazinimit (në m ³) (Maximum dedicated storage capacity m3)	Sasinë e mbetjeve që do të mbahen në bord (në m ³) Amount of waste retained on board m3	Porti ku do të dorëzohen mbetjet e mbajtura (Port at which remaining waste will be delivered)	Sasia e dorëzuar sipas llojit të mbetjes (Quantity delivered per waste type)
Vajra të përdorur (Waste oils)					
Llumra					

(Sludge)					
Ujë i sentinave (Bilge water)					
Të tjera (Përcakto) Others (specify)					
Mbetje (Garbage)					
Mbetje nga ushqimet (Food waste)					
Mbetje Plastike (Plastic)					
Mbetje të tjera (Other)					
Ujëra të ndotura (Sewage)					
Ujëra të ndotura (Sewage)					
Mbetje që shoqërojnë ngarkesat (Cargo associated waste)					
Tepricat nga ngarkesat (Cargo residues)					
Datë (Date) Firma (Signature) Vula e Kompanisë (Stamp of Company)					